

RENOFIX 200

GLET MASË (LLAÇ I BARDHË) PËR RRAFSHIM (PATINIM)
 TË MUREVE TË BRENDSHËM DHE TAVANEVE

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik!

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT:

Masë rrafshuese (glet masë) në bazë gipsi, për rrafshim (patinim) të mureve të brendshëm dhe tavaneve, paraparakisht të suvatuara me llaç themelor (gips, gëlqere, çimento), si dhe pllaka gips kartoni.

PËRMBAJTJA:

- Gips të zgjedhur
- Gëlqere
- Shtesa që i rrisin cilësitë e përpunimit
- Përbërës organikë <5%

VEÇORITË:

- Produktivitet i lartë
- Cilësi optimale e përpunimit aftësi të mirë për patinim
- Sipërfaqe të lëmuar, të butë
- Lidhshmëri të mirë
- Nuk është e nevojshme që sipërfaqja të kalohet me brus

PËRGATITJA E BAZËS:

Bazamenti duhet të jetë i thatë, i pastruar nga pluhuri, mbeturinat dhe sipërfaqet e lyera me ngjyra të shkëlqyera. Lagështia e bazamentit duhet të jetë nën 2.5% nga masa (sipas CM matjeve). Udhëzimet përgjigjen për mure që janë ndërtuar me norma të caktuara dhe që nënkuptojnë fuga të mbyllura. Nëse në mur ekzistojnë fuga apo çarje të hapura, ato duhet paraparakisht të mbyllën. Llaçet themelore çimento-gëlqerore paraparakisht duhet të jenë tharë dhe të jenë të vrazhdë.

PËRGATITJA E LLAÇIT:

Një thes Renofix 200 zbrazet në 12-12.5 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser. Materiali duhet të jetë pa toptha dhe vendoset me rrafshuese metali (gletkele), tërhiqet dhe patinohet. Kohëzgjatja e përpunimit është 50-60 min.

PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT:

Me Renofix 200 patinohen sipërfaqe të brendshme të mureve dhe tavaneve. Gjatë procesit të lidhjes duhet të sigurohen kushte të volitshme për tharje dhe ngurtësim (me ajrosje). Shtresa tjera dhe tapeta mund të vendosen pasi llaçi të jetë tharë plotësisht. Llaçet që përmbajnë gips, me rregull vendosen në një shtresë. **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzjerja me materiale tjera.



VËRREJTJE:

Përmban gëlqere të shuar. Irriton sytë dhe lëkurën. Në raste të tilla, lëkura të lahet me ujë të pastër ndërsa për sytë të kryhet kontrolli mjekësor.

PAKETIMI:

Në thasë letre nga 25 kg. që janë të mbrojtura nga lagështia.



DEPONIMI:

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 3 muaj..

Të dhëna teknike	
Numri i prodhimit	5319990620163
Shifra e prodhimit:	1200
Thasë në paletë:	40


RENOFIX 200

Sasia e nevojshme e ujit:	12-13 l./Thes
Trashësia minimale e shtresës:	0,1 mm
Harxhimi:	ca. 0,8-1 kg/m ² /mm
Shënim:	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.
Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10):	ca. 1010 kg/m ³
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11):	ca. 2.0 N/mm ²
MG (EN 998-1):	CSII W0
(EN 13279-1):	B3 / T2 / S2

Udhëzime të përgjithshme:



Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në disponimin tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjetjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: www.renova.com.mk si ose mund t'i kërkonin në sektorin e shitjes.



RENOVA PUTZ | www.renova.com.mk

RENOVA Xhepçisht, Tetovë, Maqedoni | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | info@renova.com.mk
RENOVA Gurëza, Uroševac, Kosovë | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | renova_ferizaj@hotmail.com
RENOVA Vorë, Tiranë, Shqipëri | Tel.: 00355 48 301 909 | Fax: 00355 48 301 908 | renova.tirana@hotmail.com